



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*  
*Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

---

**Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,**

Në mbështetje të nenit 38 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/09 Janar 2024), nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr.15, 12.09.2011),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) Nr.11/2024 PËR PROCEDURËN E RINDËRTIMIT TË KADASTRIT**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim rregullimin e procedurave për rindërtimin e kadastrit, analizimin, vlerësimin dhe rindërtimin e të dhënave kadastrale dhe të dhënave në RDPP, si dhe bashkëpunimin me institucionet qendrore dhe lokale për realizimin e rindërtimit të kadastrit.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, Komisionet për Rindërtimin e Kadastrit, Zyrat Kadastrale Komunale, Operatorët Ekonomik dhe të gjitha subjekteve me autorizime publike të përfshira në procesin e rindërtimit të kadastrit.

**Neni 3**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

1.1. **Rindërtimi i kadastrit dhe i Regjistrit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtëshme** - krijimi i njësive kadastrale dhe rindërtimi i të drejtave pronësore për njësitë kadastrale, regjistrimi i tyre dhe korrigjimi ose plotësimi i të dhënave të regjistruara në kadastër;

1.2. **OE** - Operatori Ekonomik;

1.3. **ZK** - Zona Kadastrale;

1.4. **RK**- Rindërtimi i Kadastrit;

1.5. **AKKVP** - Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronave.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë me shprehjet e përdorura në Ligjin Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme.

3. Në kuptim të këtij Udhëzimi Administrativ emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas, pa diskriminim.

#### **Neni 4**

#### **Plani i Rindërtimit të Kadastrit**

1. Para se të filloj procesi i RK dhe RDPP duhet të hartohet Plani i Rindërtimit të Kadastrit.

2. Plani i rindërtimit, do të hartohet nga AKK-ja në konsultim me komunën, AKKVP dhe institucionet tjera qeveritare të cilat kanë ndonjë interes në ZK e cila do të rindërtohet.

3. Plani i rindërtimit mundëson:

3.1. kornizën për zbatimin efikas, të drejtë dhe transparent të rindërtimit;

3.2. procedura të qarta dhe metoda të plota dhe të sakta të punës në procesin e rindërtimit;

3.3. vlerësimin dhe përshkrimin e gjendjes ekzistuese të kadastrit dhe të RDPP-së para rindërtimit dhe kërkesat për procesin e rindërtimit të një ZK ose të një pjese të saj.

#### **Neni 5**

#### **Përmbajtja e Planit për Rindërtimin e Kadastrit**

1. Plani për RK duhet të përmbajë:

1.1. të dhënat kadastrale për ZK apo pjesë të ZK e cila do të rindërtohet;

1.2. vlerësimin e mospërputhjes së të dhënave kadastrale me gjendjen ekzistuese në terren, e krijuar nga mos përditësimi i të dhënave në RDPP.

1.3. vlerësimin e gabimeve në të dhëna, llojin e tyre, dhe përshkrimin e nevojës për e plotësimin ose korrigjimin e tyre përmes RK;

1.4. procedurat dhe metodat e punës të cilat do të zbatohen;

1.5. regjistrin e kërkesave pronësore të pranuar nga AKKVP-ja;

1.6. vlerësimin e buxhetit të domosdoshëm dhe mënyrën e sigurimit të këtij buxheti;

1.7. bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse qendrore dhe lokale.

2. Në rastet kur bëhet RK vetëm për plotësimin ose korrigjimin e të dhënave në kadastrë, Plani i Rindërtimit nuk e përmban aktivitetin nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe 1.5 i këtij neni.

### **Neni 6**

#### **Vlerësimi i mospërputhjes së të dhënave kadastrale me gjendjen ekzistuese në terren**

1. AKK do të bëjë vlerësimin e gjendjes i të dhënave kadastrale për secilën ZK që planifikohet të rindërtohet.

2. Vlerësimi duhet të përmbajë:

2.1. dallimet dhe mospërputhjet e të dhënave kadastrale për ZK për të gjitha njësitë kadastrale;

2.2. krahasimin e të dhënave të regjistruara në RDPP dhe të paraqitura në hartat kadastrale me gjendjen faktike sipas ortofotove dhe dokumentacionin tjetër që posedon dhe që sigurohet nga mekanizmat tjerë institucional.

### **Neni 7**

#### **Caktimi i ZK për rindërtim**

1. Caktimin e ZK që do të përfshihen në rindërtim e bënë AKK me vendim të Drejtorit Ekzekutiv.

2. Me rastin e caktimit të ZK për rindërtim duhet të merren për bazë këto kritere:

2.1. niveli i lartë i mos përputhjes së të dhënave grafike me ato të RDPP-së;

2.2. niveli i lartë i mospërputhjes së të dhënave kadastrale dhe të RDPP-së me gjendjen faktike në terren;

2.3. realizimi i projekteve të caktuara me interes për institucionet e Kosovës dhe për qytetarët;

2.4. kërkesa e institucioneve lokale dhe institucioneve qendrore.

3. Para caktimit të ZK për rindërtim, AKK do të konsultohet me organet përgjegjëse të komunës dhe organet e nivelit qendror që mund të kenë ndikim në procesin e rindërtimit.

4. AKK merr vendim mbi ndërprerjen e përkohshme të aktiviteteve kadastrale në zonat e përfshira në rindërtim në të cilin vendim caktohet momenti i ndërprerjes dhe lloji i shërbimit kadastral që ndërpritet dhe njoftohet ZKK-ja përkatëse dhe OE.

### **Neni 8** **Procedurat e punës gjatë rindërtimit**

Procedurat e punës gjatë zbatimit të rindërtimit duhet të jenë në pajtueshmëri me Ligji Nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme, udhëzimet administrative, udhëzuesit e punës dhe doracakët që janë në fuqi.

### **Neni 9** **Sensibilizimi i publikut gjatë rindërtimit të kadastrit**

Fushata e sensibilizimit të publikut do të zbatohet gjatë tërë periudhës kohore të rindërtimit, por aspektet e fushatës do zhvillohen varësisht nga faza në të cilën gjendet rindërtimi.

### **Neni 10** **Informimi publik për fillimin e zbatimit të planit të rindërtimit**

1. Për Planin e RK do të informohen qytetarët e Kosovës, institucionet, palët e interesuara dhe që kanë interes ligjor nga procesi i rindërtimit, në veçanti ata të komunës dhe të ZK ku zbatohet rindërtimi.

2. Të gjitha palët e interesuara dhe që kanë interes ligjor do të informohen lidhur me përfitimet nga rindërtimi, procedurat e posaçme të cilat aplikohen gjatë rindërtimit, të drejtat dhe obligimet e palëve si dhe do të kërkohet bashkëpunim në zbatimin e procesit të rindërtimit.

### **Neni 11** **Takimet me banorët e ZK**

1. Para se të filloj zbatimi i planit të rindërtimit duhet të mbahen takimet me banorët e secilës ZK.

2. Ftesa për takim publikohet së paku shatë (7) ditë para mbajtjes së takimit.

2.1. Ftesa përmban rendin e ditës, qëllimin e mbajtjes së takimit me banorët, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë e mbajtjes së takimit.

2.2. Ftesa bëhet përmes posterave dhe fletëpalosjeve. Posterat vendosen në vendet publike ndërsa fletëpalosjet do të ju dorëzohen banorëve në dorë.

3. Informimi bëhet edhe përmes gazetave lokale dhe mjeteve elektronike të komunikimit si: radios, televizionit, rrjeteve sociale dhe web faqes së AKK-së.

4. Takimet me banorët mund të ndahen për lagje të caktuara në mënyrë që informimi të jetë i drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrja të jetë sa më e madhe.

5. OE është i obliguar që të siguroj lokalitetin apo hapësirat e përshtatshme për mbajtjen e takimit me banorët e ZK-së.

6. Në takimin me banorët e ZK-së do të marrin pjesë përfaqësuesit e Komisionit të RK, ZKK-ve dhe OE-ve. Takimi udhëhiqet nga përfaqësuesi i Komisionit të RK-së.

7. Gjatë takimit banorët informohen për:

7.1. planin e rindërtimit, dinamikën e realizimit dhe rëndësinë e tij;

7.2. obligimet dhe përgjegjësitë e AKK, ZKK, Komunës dhe Komisionit në procesin e rindërtimit;

7.3. obligimet e OE në zbatimin e planit të rindërtimit;

7.4. të drejtat dhe obligimet e banorëve të ZK në procesin e rindërtimit, si: obligimi i banorëve për dorëzimin e dokumentacionit që posedojnë për pronat e tyre, njoftimin e Komisionit për rindërtim dhe OE për problemet dhe vështirësitë që i kanë lidhur me pronat e tyre dhe informimi për proceset gjyqësore eventuale që janë në zhvillim e sipër;

7.5. Rëndësinë e bashkëpunimit të gjitha palëve pjesëmarrëse në procesin e rindërtimit.

## **Neni 12**

### **Fushata e sensibilizimit gjatë procesit të rindërtimit**

1. Fushata e sensibilizimit do zhvillohet nga Komisioni dhe OE përmes zyrave të OE edhe përmes rrjeteve sociale dhe web faqes së AKK-së.

2. Gjatë procesit të rindërtimit mund të bëhet fushatë e sensibilizimit për raste të veçanta që janë të rëndësishme për procesin e rindërtimit. Vlerësimin për domosdoshmërinë e fushatës së sensibilizimit e bënë OE, Komisioni dhe ZKK. Vendimin e merr Komisioni.

## **Neni 13**

### **Funksionalizimi i zyrave të OE**

1. OE obligohet të hap zyrë:

1.1. në komunën në të cilën zhvillohet projekti i rindërtimit pas aprovimit të planit të punës, e cila duhet të jetë e hapur gjatë tërë procesit të rindërtimit;

1.2. në ZK, e cila do të jetë e hapur gjashtë (6) muaj, duke filluar pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të fushatës së matjeve deri pesëmbëdhjetë (15) ditë pas mbylljes së shikimit publik në atë ZK;

2. Me vendim të komisionit për RK mund të caktohet afat shtesë për vazhdimin e funksionalitetit të zyrës nga nën paragrafi 1.2. i këtij neni, jo më gjatë se tre (3) muaj.

3. Orarin e punës në këto zyre e propozon OE dhe e aprovon Komisioni i RK.

#### **Neni 14**

#### **Rindërtimi i parcelave kadastrale**

1. Në raste kur ka mospërputhje të të dhënave kadastrale vetëm për pjesën grafike me pjesën tekstuale dhe gjendja faktike është e njëjtë me tekstuale, rindërtimi do të bëhet duke i krijuar dhe regjistruar parcelat kadastrale vetëm në pjesën grafike.

2. Në rastet kur ka mospërputhje të të dhënave me pjesën tekstuale me të dhënat e pjesës grafike, dhe gjendja faktike është e njëjtë me pjesën grafike, rindërtimi do të bëhet duke i korrigjuar të dhënat në tekstuale.

3. Në rastet kur njësia kadastrale nuk është e regjistruar në regjistër kadastral, atëherë duhet të rilevohet gjendja faktike dhe të behet regjistrimi fillestar, duke trajtuar edhe dokumentacionin që posedojnë palët apo institucionet përkatëse.

4. Në rastet kur gjendja faktike në terren ndryshon nga gjendja grafike dhe ajo tekstuale, të njëjtat të krijohen dhe regjistrohen në pjesën grafike dhe tekstuale.

5. Formimi i parcelave kadastrale bëhen edhe në rastet kur nuk e kërkon pronari i parcelës me qëllim të zyrtarizmit të gjendjes faktike.

6. Parcelat kadastrale duhet të përmbajnë të dhënat për regjistrim në pjesën grafike dhe për regjistrim në pjesën tekstuale siç është e përcaktuar me Ligjin Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimet Administrative për krijimin e njësive kadastrale.

7. Mënyra e matjeve dhe krijimit të njësive kadastral rregullohet me udhëzues.

#### **Neni 15**

#### **Rindërtimi i njësive kadastrale, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave**

1. Gjatë RK duhet të maten ndërtesat të cilat janë të ndërtuar në parcelën kadastrale.

2. Për te gjitha ndërtesat e matura duhet të përgatitet elaborati teknik sipas Ligjit përkatës për Trajtimin e Ndërtimeve Paleje, i cili i dorëzohet pronarit dhe organit kompetent.

3. Ndërtesat të cilat i plotësojnë kushtet ligjore regjistrohen në regjistrat kadastral.

4. Të gjitha ndërtesat e matura që nuk përfshihen ne paragrafin 2 te këtij neni duhet të paraqiten në një shtresë të veçantë dhe të njëjtat ti dorëzohen organeve kompetente.

5. Nëse në regjistrat kadastral është e regjistruar ndërtesa ndërsa në terren nuk ekziston, ndërtesa e tillë duhet të çregjistrohet nga regjistri edhe pa pëlqimin e pronarit.

6. Njësia kadastrale ndërtesë e rindërtuar duhet të përmbajë të dhënat që kërkohen sipas Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ për krijimin e njësive kadastrale.

7. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për rindërtimin e njësive kadastrale të pjesëve të ndërtesave.

### **Neni 16**

#### **Rindërtimi i të drejtave tjera dhe ngarkesave pronësore për njësi kadastrale**

Nëse gjatë procesit të RK në një ZK hasen edhe njësi kadastrale të cilat janë të ngarkuara me ngarkesa pronësore si hipoteka, servitute dhe barra tatimore, matja, formimi dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme dhe Udhëzimeve Administrative për procedurat e regjistrimit, modifikimit dhe fshirjes së hipotekës, barrës dhe ngarkesave tjera dhe sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë këto çështje.

### **Neni 17**

#### **Zyrtarizimi i të drejtave pronësore dhe regjistrimi i tyre në RDPP**

1. Në rastet në të cilat të drejtat pronësore nuk e pasqyrojnë gjendjen faktike respektivisht nuk janë zyrtarizuar transaksionet e pronave apo nuk janë kryer procedurat e trashëgimisë, bëhet zyrtarizimi i transaksioneve jozyrtare dhe zhvillimi i procedurave të trashëgimisë.

2. Zyrtarizimi i transaksioneve jo zyrtare, përmes RK bëhet vetëm në ZK të përfshira në rindërtim.

3. Shqyrtimi i procesit të trashëgimisë, përmes RK bëhet përveç në ZK të përfshirë në rindërtim edhe në të gjitha ZK tjera ku trashëgimlënësi ka prona pavarësisht nëse janë pjesë e RK.

### **Neni 18**

#### **Procedurat e zyrtarizimit të transaksioneve jo zyrtare**

1. Për zyrtarizimin e transaksioneve jo zyrtare, OE:

1.1. përgatitë materialet për informimin publik, në bashkëpunim me nën-komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me regjistra kadastral dhe i shpall ato në kohën dhe vendin e përcaktuar nga Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP .

1.2. mbështetë nën komisionin në organizimin e informimit publik dhe organizimin e seancave dëgjimore.

1.3. identifikon të gjitha rastet e transaksioneve jo zyrtare duke kërkuar dokumente juridike nga pronarët-shfrytëzuesit faktik dhe nga institucionet shtetërore që mund të posedojnë si aktgjykime, aktvendime, kontrata, marrëveshje dhe dokumente të tjera. Pranimi i dokumentacionit të tillë do të bëhet deri në përfundimin e shikimit publik.

1.4. i dërgon nën-komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP, listën e të gjitha rasteve të transaksioneve jo zyrtare të identifikuara dhe dokumentet eventuale të siguruar nga institucionet përkatëse apo pronari,shfrytëzuesi faktik i pronës.

1.5. harton procesverbal për aktivitetet nga ky paragraf të cilin do ta nënshkruaj personi përgjegjës i OE.

2. Për rastet e transaksioneve për të cilat ka pranuar dokumente të plotfuqishme juridike për krijimin e të drejtës pronësore, nën komisioni pas verifikimit të tyre, i propozon Komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen për zyrtarizimin e gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me regjistrin kadastral, nxjerrjen e Vendimit për regjistrimin e tyre.

3. Në rastet kur gjatë seancës dëgjimore janë prezent personi në emër të të cilit është e regjistruar njësia kadastrale në regjistra kadastral dhe pronari faktik dhe ata pajtohen se transaksioni jo zyrtar është kryer si dhe obligimet e palëve janë përmbushur i propozon Komisionit për marrjen e Vendimit për zyrtarizimin e transaksionit dhe regjistrimin në regjistra kadastral.

4. Rastet për të cilat nuk ka ndonjë dokument të plotfuqishëm juridik për krijimin e të drejtës pronësore dhe pronari nuk gjendet, nën komisioni me mbështetjen e OE, mban takime dhe merr deklarata me shkrim nga personat që kanë kryer një transaksion e që nuk e kanë zyrtarizuar dhe nga dëshmitarët eventuale si dhe shqyrton provat e propozuara nga palët e interesuara, të siguruar nga nën komisioni apo OE, me të cilat mund të dëshmohet transaksioni jo formal.

5. Bazuar në provat nga paragrafi 4 i këtij neni Komisioni merr Vendim për zyrtarizimin ose jo të transaksionit dhe regjistrimit në regjistra kadastral.

6. Komisioni për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me regjistra kadastral nuk do të shqyrton rastet e transaksioneve jo zyrtare për të cilat është parashtruar kërkesë në AKKVP para apo gjatë zhvillimit të projektit të rindërtimit.

## **Neni 19**

### **Provat dhe baza e nxjerrjes së vendimit për zyrtarizimin e transaksionit jo zyrtar**

1. Komisioni, për nxjerrjen e vendimit për zyrtarizimin e transaksionit jo zyrtar, bazohet në njëren nga provat si:



- 1.1. kontratën e nënshkruar nga të dy palët por të pa vërtetuar te organi kompetent;
  - 1.2. faturën apo vërtetimin e pagesës së çmimit të shitblerjes, të nënshkruar nga palët;
  - 1.3. faturat e pagesës së shpenzimeve komunale si rrymës, ujit, mbeturinave;
  - 1.4. deklaratat me shkrim të palëve për pëlqimin e tyre;
2. Përveç dokumenteve të cekur në paragrafin 1 është e nevojshme edhe deklarata me shkrim e dëshmitarëve.
3. Formalizimi i transaksionit jo zyrtar të pronave të paluajtshme mund të bazohet në:
- 3.1. pranimin e pronarit zyrtar të pronës/ve të paluajtshme apo trashëgimtarëve të tij;
  - 3.2. parashkrimin fitues;
  - 3.3. përmbushjen e plotë të pagesës së çmimit të paluajtshmërisë nga pronari faktik apo paraardhësi i tij;
  - 3.4. dëshmitë dhe provat tjera me të cilat vërtetohet se transaksioni jo zyrtar është kryer.

## **Neni 20**

### **Procedura për zyrtarizimin e trashëgimive të pa kryera**

1. Për zyrtarizimin e trashëgimive të pa kryera OE:
  - 1.1. përgatitë materialet për informimin publik, në bashkëpunim me nën-komisionin për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me RDPP dhe i shpall ato në kohën dhe vendin e përcaktuar nga Komisioni;
  - 1.2. mbështetë nën komisionin në organizimin e informimit publik dhe organizimin e seancave dëgjimore për mundësinë dhe rëndësinë e kryerjes së procedurave të trashëgimisë;
  - 1.3. identifikon të gjitha rastet e trashëgimive të pa kryera në ZK ku bëhet rindërtimi duke krahasuar gjendjen në të dhënat kadastrale dhe duke u bazuar në deklaratat e pronarëve faktik të pronës;
  - 1.4. siguron pëlqimin e trashëgimtarëve për zhvillimin e procedurave të trashëgimisë si dhe zotimit se do të sigurojnë dokumentacionin që kërkohet nga trashëgimtarët potencial;
  - 1.5. i dërgon nën-komisionit për shqyrtimin dhe vendosjen e zyrtarizimit të gjendjes faktike dhe mospërputhjeve me regjistra kadastral, listën e të gjitha rasteve të trashëgimive të pakryera dhe dokumentet eventuale të siguruar nga institucionet përkatëse apo pronari-shfrytëzuesi faktik i pronës gjegjësisht trashëgimtarët potencial, që kanë të bëjnë me trashëgiminë;

1.6. harton procesverbal për aktivitetet nga ky paragraf, të cilin do ta nënshkruaj personi përgjegjës i OE;

## **Neni 21**

### **Fillimi i procedurës**

1. Për fillimin e procedurës së trashëgimisë duhet siguruar dëshmia e vdekjes së trashëgimlënësit, certifikata e pronësisë, certifikatat e lindjes së të gjithë trashëgimtarëve potencial, certifikata e vdekjes së ndonjë nga trashëgimtarët, nëse ka raste të tilla.

2. Me rastin e nxjerrjes së dëshmisë së vdekjes duhet siguruar që të mos përjashtohet asnjë nga trashëgimtarët ligjor. Nën komisioni, me mbështetjen e OE mund të bëjë verifikimin e dëshmisë së vdekjes përmes Zyrës përkatëse të Regjistrit Civil.

3. Gjithashtu sigurohen dokumentet juridike nga pronarët-shfrytëzuesit faktik, nga trashëgimtarët potencial dhe nga institucionet shtetërore që eventualisht mund ti posedojnë si: aktgjykim apo aktvendim të trashëgimisë, testament, dokument që dëshmon për obligimet eventuale të trashëgimlënësit.

4. Dokumentacionin nga paragrafi 1 dhe 3 të këtij neni, me rekomandimin e nën-komisionit i siguron:

4.1. zyrtari/et që mbështesin punën e komisionit;

4.2. OE;

4.3. palët; apo

4.4. palët e treta që kanë interes.

5. Për rastet e zhvillimit të procedurës së trashëgimisë përveç vendosjes së shpalljeve në ZK, ato publikohen në Web faqen e AKK-së dhe në portalin e Gazetës Zyrtare të Kosovës, në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

6. Në rastet kur janë gjetur dokumente juridike si aktgjykime, aktvendime apo dokumente tjera që dëshmojnë se trashëgimia është kryer, nën komisioni ia përcjell Komisionit. Sipas këtyre dokumenteve, Komisioni nxjerr Vendim për azhurnimin e regjistrimit të trashëgimisë në RDPP.

## **Neni 22**

### **Zhvillimi i procedurës**

1. Nën komisioni është përgjegjës për mbajtjen e seancave informuese në të cilat do t'i ftojë të gjithë trashëgimtarët e mundshëm dhe do t'i njoftojë me të drejtat dhe detyrimet e tyre si trashëgimtarë si dhe pasojat e heqjes dorë nga trashëgimia.

2. Për veprimet e kryera gjatë procedurës trashëgimore, marrjen e provave dhe të deklaratave për heqjen dorë nga trashëgimia dhe veprimet tjera procedurale, nën komisioni përpilon procesverbal, të cilin e nënshkruajnë kryetari dhe anëtarët e nën komisionit dhe pjesëmarrësit në seancë.

3. Pas kryerjes së veprimeve procedurale, nën komisioni përgatit raportin me propozim për vendosje dhe ia dërgon Komisionit. Raportit i bashkëngjiten procesverbalet, dhe të gjitha provat dhe dëshmitë e siguruara.

4. Në bazë të propozimit dhe dokumentacionit të pranuar nga nën komisioni, Komisioni nxjerr Vendim për zyrtarizimin e trashëgimisë.

5. Në procedurën e trajtimit të trashëgimisë, Komisioni dhe nën komisioni i zbatojnë dispozitat në fuqi të Ligjit përkatës për Trashëgimin, Ligjit përkatës për Procedurën Jo Kontestimore dhe dispozitat tjera ligjore që kanë të bëjnë me zyrtarizimin e trashëgimive të pa kryera.

### **Neni 23**

#### **Kontestimi i zyrtarizimit dhe ndërprerja e procedurës**

1. Në rastin kur palët gjatë seancës dëgjimore me nën komisionin e kontestojnë zyrtarizimin e të drejtave jo zyrtare pronësore sipas transaksionit jo formal apo trashëgimive të pa kryera dhe nuk pajtohet për ndryshimin e të drejtave pronësore atëherë Komisioni me propozimin e nën komisionit merr vendim për ndërprerjen e procedurës dhe e përjashton atë njësi kadastrale për të cilën nuk është zhvilluar trashëgimia. nga rindërtimi ndërsa palët i udhëzon në procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

2. Për përjashtimin e njësive kadastrale nga rindërtimi njoftohet OE.

### **Neni 24**

#### **Rindërtimi i njësive kadastrale dhe të drejtave pronësore për pronat shtetërore, komunale dhe shoqërore**

1. Kur gjatë RK haset në pronat shtetërore, shoqërore ose komunale, për rindërtimin e tyre nën komisioni përkatësisht OE duhet të kontaktoj dhe të bashkëpunojë me subjektet përgjegjëse të cilat sipas ligjeve përkatëse i menaxhojnë dhe administrojnë këto prona siç janë:

1.1. Institucionet përkatëse qendrore;

1.2. Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

1.3. Komuna;

1.4. Ndërmarrjet publike.

2. Ftesa dhe komunikimi i OE me institucionet përgjegjëse nga nën paragrafi 1.1. deri në nën paragrafin 1.4 të këtij neni, bëhet me shkrim.

3. Asnjë ndryshim i të drejtave pronësore për pronat e përcaktuara nga paragrafi 1. i këtij neni, nuk mund të bëhet pa pëlqimin e institucioneve kompetente.

### **Neni 25**

#### **Prona shtetërore, komunale dhe shoqërore e uzurpuar**

1. Prona shtetërore, komunale dhe shoqërore e uzurpuar, mund të jetë pjesë e procesit të rindërtimit, me pëlqimin e institucioneve përgjegjëse.
2. Prona shtetërore, komunale dhe shoqërore e uzurpuar, gjatë procesit të rindërtimit duhet të listohet ndaras nga parcelat tjera. Gjithashtu në pjesën grafike prona e uzurpuar duhet të dallohet nga sipërfaqja që nuk është e uzurpuar.

### **Neni 26**

#### **Krijimi i të dhënave nga procesi i rindërtimit**

1. Me rastin e rindërtimit, përgatiten të dhënat që janë paraparë me planin e rindërtimit:
  - 1.1. njësitë kadastrale të rindërtuara dhe të pa rindërtuara, me të gjitha informacionet kadastrale duhet të pasqyrohen në pjesën grafike për tërë ZK;
  - 1.2. regjistri i personave dhe pronarëve të përfshirë në procesin e rindërtimit me të drejta pronësore në njësitë kadastrale për tërë ZK-në.
2. AKK-ja i nxjerrë udhëzuesit për procedurën teknike të grumbullimit të informatave në teren, formatin i cili shfrytëzohet dhe sistemet në të cilat informatat e grumbulluara do të pasqyrohen dhe dorëzohen në AKK.

### **Neni 27**

#### **Kontrolli i kualitetit të të dhënave kadastrale të rindërtimit**

1. Pas formimit të njërive kadastrale, krijimit të regjistrave sipas nenit 25 të këtij Udhëzimi Administrativ, OE bënë kontrollin e kualitetit të të dhënave të krijuara në procesin e rindërtimit. Të dhënat e kontrolluara nga OE i dorëzohen AKK-së.
2. AKK apo subjekti i caktuar nga AKK para shikimit publik duhet ta bëjë kontrollin e kualitetit bazuar në udhëzues për kontrollimin e kualitetit të RK dhe të kadastrit të ndërtesave.
3. AKK për aktivitetet nga paragrafi 2 i këtij neni mund të bëjë kontrollin e kualitetit përmes OE.

### **Neni 28**

#### **Përgatitja dhe aprovimi i materialeve dhe dokumenteve për fushatën e shikimit publik**

1. Materialet për shikim publik siç janë: posteret, fletëpalosjet, broshurat, përgatiten dhe publikohen nga OE . Përmbajtjen, formën, madhësinë, numrin dhe planin e shpërndarjes së tyre e aprovon komisioni i rindërtimit.

2. AKK dhe komisioni kur e vlerësojnë se është e domosdoshme mund të përgatisin dhe të lëshojnë informime të ndryshme që janë në interes të rindërtimit.
3. Të gjitha materialet nga fushata e shikimit publik dhe të dhënat nga rindërtimi i kadastrit publikohen në Web faqen e AKK.
4. Materiali për Fushatën e shikimit publik përpilohet në gjuhët zyrtare të qytetarëve të ZK-së e cila rindërtohet.

## **Neni 29** **Shikimi publik**

1. Të dhënat e krijuara gjatë zhvillimit të procesit të rindërtimit publikohen në shikim publik.
2. Komisioni për RK merr Vendim me shkrim për lejimin e shikimit publik të të dhënave nga rindërtimi dhe vendim për aprovimin e të dhënave pas përfundimit të shikimit publik, që shërbejnë si bazë për regjistrim.
3. Para së të filloj shikimi publik i të dhënave nga rindërtimi i kadastrit duhet të bëhet fushatë e veçantë e informimit.
4. Së paku shtatë (7) ditë para fillimit të shikimit publik duhet të publikohen posterat dhe fletëpalosjet në vendet publike në territorin e ZK.
5. Në postera dhe fletëpalosje duhet të shënohet data e fillimit dhe e përfundimit të shikimit publik, vendi ku mbahen të dhënat për shikim publik, orari i publikimit të të dhënave nga rindërtimi.
6. Posterat dhe fletëpalosjet duhet të jenë të publikuara dhe të shpërndara gjatë gjithë kohës së shikimit publik.
7. Data e fillimit të shikimit publik do të publikohet edhe në mjetet e informimit publik, në televizionet, radiot lokale, rrjetet sociale, web faqen e AKK-së dhe së paku në dy (2) gazeta nacionale. Kjo do të përsëritet pa ndërprerë në 5 ditët e para të fillimit të shikimit publik dhe në 5 ditët e fundit të afatit të shikimit publik.
8. Angazhime të posaçme do të bëhen për personat me nevoja të veçanta për t'ju mundësuar informim të plotë për të dhënat e pronave të tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.
9. Shikimi publik zgjat gjashtëdhjetë (60) ditë.
10. Të dhënat nga shikimi publik bëhet edhe përmes web faqes së AKK-së.
11. Gjatë fazës së shikimit publik OE duhet t'i pranoj të gjitha kërkesat dhe ankesat e qytetarëve dhe për këtë duhet të mbaj një regjistër. Kërkesat apo ankesat e qytetarëve duhet të pranohen me shkrim. OE duhet të mbajë evidencën e të gjithë personave që vizitojnë hapësirat ku mbahet

shikimi publik. Formati i regjistrit të ankesave, kërkesave dhe regjistri i vizitorëve të shikimit publik caktohet nga AKK.

12. Ekspertët e OE duhet të jenë prezent gjatë gjithë kohës së shikimit publik për t'u dhënë sqarime palëve për kërkesat e tyre. Ekspertët e OE mund të kërkojnë ndihmë edhe nga nën komisioni për rindërtim.

### **Neni 30**

#### **Vendosja për kërkesat apo ankesat nga shikimi publik**

1. Nën komisioni me mbështetjen e OE, shqyrton të gjitha kërkesat apo ankesat e parashtruara për të dhënat e shpallura në shikim publik dhe mban seanca dëgjimore me të gjithë palët që kanë parashtruar ankesë apo kërkesë.

2. Në seancën dëgjimore ftohen edhe palët interesat e të cilëve preken nga të dhënat e rindërtimit apo që kanë interes juridik.

3. Në rastet kur palët nuk paraqiten sipas ftesës së rregullt, merret vendimi sipas dokumentacionit që posedon dhe gjendjes së vërtetuar faktike.

4. Për çdo kërkesë apo ankesë të parashtruar, me propozim të nën komisionit, komisioni merr vendim.

5. Në rastet kur nuk mund të arrihet marrëveshje me palët gjatë seancës dëgjimore, komisioni apo nën komisioni merr vendim me të cilin pala udhëzohet për mënyrën dhe procedurën e ankimit të mëtutjeshëm sipas Ligjit Nr. 08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme.

### **Neni 31**

#### **Përmbyllja e procesit të rindërtimit**

1. Pas përfundimit të shikimit publik komisioni harton raportin për përfundimin e rindërtimit për ZK.

2. Komisioni merr vendim për shpalljen e zonës kadastrale të rindërtuar.

3. Vendimi i komisionit është bazë që të dhënat nga rindërtimi të futen në regjistrin kadastral.

4. Të gjithë pronarët e ZK të përfshirë në procesin e rindërtimit pajisen nga ZKK me Certifikatën mbi të drejtën e pronës së paluajtshme, pa pagesë.

### **Neni 32**

#### **Financimi i rindërtimit**

1. Shpenzimet për rindërtim mbulohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës me përjashtim të rastit kur Kuvendi Komunal, për arsye të caktuara, kërkon rindërtimin. Në atë rast Komuna i

mbulon shpenzimet nga buxhetit Komunal. Fondet për rindërtim do të jenë në dispozicion përmes buxhetit të AKK-së.

2. Në rastet kur nga institucionet ose subjektet e ndryshme kërkohet që të zbatohet rindërtimi për nevoja të veçanta të tyre, shpenzimet i mbulon subjekti që e kërkon rindërtimin.

3. Rindërtimi mund të zbatohet edhe me buxhetin e siguruar nga donacionet dhe kreditë e shteteve të ndryshme, në bazë të marrëveshjeve ndërshtetërore.

### **Neni 33** **Bashkëpunimi ndërinstitucional**

1. Institucionet qendrore dhe lokale janë të obliguara që të bashkëpunojnë ndërmjet vete, me qëllim të përfundimit të rindërtimit.

2. AKK-ja është e obliguar që OE t'i dorëzoj të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e rindërtimit në afatin e përcaktuar me planin e rindërtimit, ose në afatin e caktuar me kontratë.

3. ZKK-ja, në territorin e së cilës zhvillohet rindërtimi është e obliguar që AKK-së t'ia dorëzoj të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e rindërtimit, në afatin që do të caktohet nga AKK.

4. Pas caktimit të ZK që do të përfshihen në rindërtim, AKK e njofton AKKVP-në me listën e zonave kadastrale të përfshira në RK si dhe për kohëzgjatjen e projektit.

5. AKKVP e njofton AKK-në me listën e kërkesave të pranuar për pronat në ato ZK si dhe në vazhdimësi e njofton për kërkesat e reja të pranuar gjatë kohëzgjatjes së projektit.

6. AKKVP, e njofton AKK-në me regjistrin e të gjitha kërkesave pronësore të parashtruara në këtë Agjenci dhe në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore dhe Agjencinë Kosovare për Prona, të cilat nuk mund të trajtohen gjatë rindërtimit për njësit kadastrale të përfshira në rindërtim, si dhe për statusin e tyre por regjistrohen vendimet e tyre. Regjistri i dorëzohet OE i cili është i obliguar ta respektoj për të gjitha rastet veç e veç.

7. Institucionet që posedojnë të dhëna që mund të kontribuojnë në procesin e rindërtimit, janë të obliguara që këto të dhëna t'i dorëzojnë në AKK brenda afatit që caktohet nga AKK ose komisioni.

### **Neni 34** **Dispozitat përfundimtare**

Për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ, AKK nxjerr udhëzues.

### **Neni 35** **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Liburn ALIU**

---

Ministër i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Datë 07.05.2024

Prishtinë